

STATUTI I SHOQËRISË dhe AKT THEMELIMI

“EXCHANGE SHPATAJ” SHPK

Sot me date 29/07/2019, ne perputhje me:

- Ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare";
- Ligjin nr.9723, date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Biznesit”

Z. YLBER SHPATAJ, shtetas Shqiptar, i lindur me 14.01.1988 ne Qam, Kukës dhe banues ne Tirane, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i Leternjoftimit me nr.personal I80114025F themelon ne cilesine e Ortakut te Vetem, Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar “EXCHANGE SHPATAJ”SHPK me permbajtjen si me poshte vijon:

KAPITULLI I

FORMA; KOHËZGJATJA; ZYRA QENDRORE; OBJEKTI

Neni 1: Forma Juridike

Shoqeria “EXCHANGE SHPATAJ”SHPK, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”), e themeluar nga personi fizik i siperpermendur, i cili nuk pergjigjet per detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara

Neni 2: Kohezgjatja

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pakufizuar qe fillon prej dates se regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar, pranë Qendres Kombetare te Biznesit (me poshte referuar si QKB).

Në përputhje më këtë statut, shoqëria mund të pezulloje ose mbyllë veprimtarinë e saj kur e shoh të arsyeshme, apo në rastet e parashikuara nga ligji.

Neni 3: Zyra Qendrore

Zyra Qendrore e Shoqerise ndodhet ne adresen: **Tirane, Njesia bashkiake nr 7, rruga Kongresi i Permetit, pallati 85, kati 1, ap 44.**

Gjate ushtrimit aktivitetit te saj, shoqeria mund te hap dege ose zyra perfaqesimi si brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

Neni 4: Objekti

Shoqeria do te kete per objekt kryesor te veprimtarise se saj:

- a) KembimValutor.
- b) Transferim te Parave ne emer dhe per llogari te institucionit financiar jo Banke
- c) Ushtrimi i veprimtarise se ndermjetesimit ne sigurime si agjent.
- d) Ushtrimi i veprimtarise si agjent Postar.
- e) Organizime paketash turistike dhe pushimesh ne grup dhe individuale. Shitje biletash avioni, trageti dhe autobusi, rezervim hotelesh dhe sherbime te tjera ne fushen e turizmit brenda dhe jashte vendit.

-Gjithashtu, per te realizuar objektivat e saj, shoqeria mund te ndermarre e te zhvilloje edhe cdo lloj aktiviteti tjetër te ligjshem ne territorin e Republikës se Shqipërisë dhe qe siguron te ardhura dhe fitime te ligjshme.

- Objekti i shoqërisë mund te zgjerohet apo zvogelohet ne varesi te interesave te shoqërisë dhe ne baze te vendimit te asamblese se pergjithshme te ortakeve.

KAPITULLI II **KAPITALI**

Neni 5: Kapitali themeltar

5.1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 4.000.000 lek i formuar ne mase te plote nga kontributi i ortakut dhe i ndare ne nje kuote me vlere nominale sipas ndarjes se meposhtme. Cdo kuote njesie ka te drejten e nje vote. Pjesmarrja e themeluesit ne kapitalin e shoqërisë është ne perputhje me kontributin e tij si me poshte:

Ortaku themelues, Ylber Shpataj, zoterues i nje kuote me vlere te pergjithshme 4.000.000(kater milion)lek, qe perben 100% te kapitalit themltar te shoqërisë.

KAPITULLI III **DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI**

Neni 6

Organet kryesore drejtuese te shoqërisë jane:

- Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve
- Administratori

Neni 7

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve

Te drejtat dhe detyrimet

7.1. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

7.2. Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per cheshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqerisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) cheshtje të tjera të parashikuara nga ligji

7.3. Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së pergjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqerisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 8

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Pergjithshme së Ortakeve

8.1. Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet një njoftimi me shkresë drejtuar ortakeve te shoqerise. Njoftimi me shkresë duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

8.2. Kur asambleja e pergjithshme nuk është thirrur sipas pikës 10.1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 9 Kuorumi

a) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

b) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare “, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht dhe votojnë me shkresë.

c) Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 10 Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 11 Administrimi

11.1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë, të cilët duhet të jenë detyrimisht ortakë të saj. Afati i emërimit të administratorit është **5 vjet**, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare e Biznesit.

11.2. Administrator i parë i shoqërisë është **Z. Ylber Shpataj, i cili zgjidhet për një periudhë 5 vjeçare.**

11.3. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorët në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

Neni 12 Kompetencat e administratorëve

Administratoret kane të drejtë e detyrohen të:

a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;

c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Neni 13

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, kompetente do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor nen juridiksionin e se cilit shtrihet aktiviteti i shoqerise.

Neni 14

Largimi i ortakut

Ky statut nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e ortakut për t'u larguar nga shoqëria dhe të drejtën e shoqërisë për të përjashtuar ortakun ne baze te dispozitave perkatese te legjislacionit tregtar ne fuqi.

Neni 15

Dispozita perfundimtare

Ne cdo rast, palet do ti referohen dispozitave ligjore te ligjit 9901, date 14.4.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" per zgjidhjen e ceshtjeve konkrete dhe te detajuara te cilat nuk jane permendur specifikisht ne kete akt themelimi personi juridik.

Ky statut u redaktua ne 3 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi u miratua ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i Vetem i Shoqerise, u nenshkrua rregullisht nga ai pa asnje verejtje.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

YLBER SHPATAJ

Ylber Shpataj

